

Shërbuesit për
Procedurë, Votim
Ollu Gjilica



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2023

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Baza Ligjore: Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar zonja Kryetare,

Prej më shumë se dy muaj deputetët e opozitës me sjelljet e tyre kanë cënuar zhvillimin e rregullt të seancave plenare, duke qenë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Të njëjtat skenare bllokimi deputetë të caktuar të opozitës kanë përdorur dhe në seancën plenare të datës 7 dhjetor 2023. Seancë dedikuar votimit nen për nen dhe në tërësi të Buxhetit të vitit 2024 dhe Paketës Fiskale.

Deputetët Ervin Salianji, Bledjon Nallbati, Asllan Dogjani, Lefter Gështhenja, Isuf Çela, Xhelal Mziu, sapo hynë në sallën e seancës plenare kanë tentuar për ta shkatërruar atë. Ata kanë marrë karriget nga vendet përkatëse dhe i kanë hedhur me forcë me qëllim bllokimin e foltores duke dëmtuar ekranin ku shfaqet rendi i ditës.

Deputetët janë konfliktuar fizikisht, duke shtyrë dhe goditur me karrige punonjësit e Gardës, të cilët ushtrojnë detyrën e tyre për të siguruar rend dhe qetësi në sallën e Parlamentit.

Me fillimin e seancës plenare, deputetët Bledjon Nallbati, Asllan Dogjani dhe Ervin Saliqji përdorën mjete piroteknike (flakadanë dhe kapsolla) të ndihmuar dhe nga deputeti Luan Baçi i cili mbante me vete disa flakadanë. Veprimet e deputetëve penguan zhvillimin e rregullt të rendit të ditës duke detyruar drejtuesen e seancës të kalojë në procesin e votimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 63, pika 1 gërma d), dhe nenit 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe e), nenin 8, pika 2 gërma b) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën :

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Bledjon Nallbati, Asllan Dogjani, Ervin Saliqji, Lefter Gështhenja, Isuf Çela, Xhelal Mziu, Luan Baçi, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT:

1. ANDUËL TAMIRI
2. Shi Metaj
3. Arbena Shumali
4. Pranvera Resuli
5. Blazha Zeqaj
6. Hatixhe Konomi
7. Dasantila Valinog